

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**PROGRAMI**  
**I KURSIT TË UNIFIKUAR**  
**“AUTOMEKANIKË”**

**Kodi: PK-M-5-21**

Miratoi:

**MINISTRI**

.....

**Tiranë, 2021**

## PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

### “AUTOMEKANIKË” (PK-M-5-21)

#### **I. Profili Profesional i Automekanikut**

##### **a) Karakteristikat e automekanikut**

Automekaniku është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar në ndërmarrje të shërbimeve të mjeteve (të lehta) të transportit ose si i vetëpunësuar në servise për punimet automekanike të këtyre automjeteve.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, automekaniku duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të automekanikut për automjetet.

Suksesi i automekanikut është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

##### **b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e automekanikut**

Profesioni i automekanikut është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve. Ai mund të punësohet në ndërmarrje të shërbimeve të automjeteve ose të vetëpunësohet në servise të këtyre automjeteve dhe në dyqane të shitjes së pjesëve të këmbimit.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë, automekaniku mund të përparojë profesionalisht në nivelin e automekanikut të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale, trajnimit në qendra të formimit profesional apo nëpërmjet punës, një automekanik mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit për mjetet e transportit.

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Riparues dhe mirëmbajtës të automjeteve”, me kod 7231, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: motorist, xhenerik, elektroauto, gomist, montues dhe riparues të sistemeve ngrohëse-ftohëse në automjete, llamarinist dhe bojaxhi në automjete, pompist, baterist etj.

#### **II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Automekanikë.**

Në përfundin të Kursit për Automekanikë, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për shërbime në automjetet e lehta.
- Realizojnë organizimin e vogël të punës në repartin ose servisën për shërbime në automjete.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, instrumentat, makineritë dhe materialet e duhura të punës.
- Përzgjedhin pjesët e këmbimit për automjetet.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.

- Kryejnë matje dhe kontrole që lidhen me shërbimet në automjetet e lehta.
- Realizojnë procedurat e çmontimit dhe e montimit të pjesëve të automjeteve të lehta.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e motorit.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e freksionit.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e kutisë së shpejtësisë.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e elementeve të transmisionit.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e elementeve të sistemit të drejtimit.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e elementeve të sistemit të frenimit.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e elementeve të sistemit të ecjes.
- Realizojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e elementeve të sistemit elektrik.
- Realizojnë diagnostikimin e parregullsive të automjeteve të lehta
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në automjetet e lehta.
- Plotësojnë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet në automjetet e lehta.
- Zbatojnë standardet e profesionit të automekanikut për automjetet e lehta.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të automjeteve.
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

### III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Automekanikë.

Pjesmarrësit në Kursin për Automekanikë duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

### IV. Kohëzgjatja e Kursit për Automekanikë

**360** orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

### V. Modulet e Kursit për Automekanikë

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e automekanikut	MK-18-251-2I	60 orë mësimore  Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të automekanikut.</li> <li>2. Kursanti përshkruan ndërtimin e përgjithshëm të automjeteve të lehta.</li> <li>3. Kursanti përshkruan motorët për automjetet e lehta.</li> <li>4. Kursanti përshkruan pjesët xhenerike të automjeteve të lehta.</li> <li>5. Kursanti përshkruan sistemin elektrik të automjeteve të lehta</li> <li>6. Kursanti përdor dokumentacionin teknik për shërbimet në automjetet e lehta.</li> <li>7. Kursanti përshkruan mirëmbajtjen, riparimin dhe diagnostikimin në automjetet e lehta.</li> <li>8. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e automjeteve të lehta</li> </ol>

<b>2</b>	Punime në motorin e automjetit të lehtë	MK-18-252-21	90 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti zmonton e monton pjesët e motorit të automjetit.</li> <li>2. Kursanti kryen shërbime në mekanizmat e motorit.</li> <li>3. Kursanti kryen shërbime në sistemin e ushqimit të motorit.</li> <li>4. Kursanti kryen shërbime në sistemin e ftohjes së motorit.</li> <li>5. Kursanti shërbime në sistemin e vajtjes së motorit.</li> <li>6. Kursanti kryen shërbime në sistemin elektrik të motorit.</li> </ol>
<b>3</b>	Punime në transmisionin e automjetit të lehtë	MK-18-253-21	70 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen shërbime në friksionin e automjetit.</li> <li>2. Kursanti kryen shërbime në kutitë e shpejtësisë mekanike dhe automatike.</li> <li>3. Kursanti kryen shërbime në transmisionin kardanak të automjetit.</li> <li>4. Kursanti kryen shërbime në transmisionin kryesor, diferencialin dhe gjysëmboshtet e automjetit</li> </ol>
<b>4</b>	Punime në sistemin e drejtimit të automjetit të lehtë	MK-18-254-21	40 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen shërbime në sistemin e levave të kthimit të automjetit.</li> <li>2. Kursanti kryen shërbime në mekanizmin e kthimit të sistemit të drejtimit të automjetit.</li> <li>3. Kursanti kryen shërbime në përforcuesit të sistemit të drejtimit të automjetit.</li> <li>4. Kursanti kryen shërbime në grupin e timonit të sistemit të drejtimit të automjetit.</li> </ol>
<b>5</b>	Punime në sistemin e frenimit të automjetit të lehtë	MK-18-255-21	40 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen shërbime në frenat e automjetit.</li> <li>2. Kursanti kryen shërbime në sistemin e frenimit me ABS të automjetit.</li> <li>3. Kursanti kryen shërbime në mekanizmin hidraulik të komandimit të frenave të automjetit.</li> <li>4. Kursanti kryen shërbime në mekanizmin e frenave të dorës së automjetit.</li> </ol>
<b>6</b>	Punime në sistemin e elektrik të automjetit të lehtë	MK-18-256-21	30 orë mësimore  Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen shërbime në burimet e ushqimit me energji elektrike të automjetit.</li> <li>2. Kursanti kryen shërbime në elementet e sistemit elektrik të automjetit.</li> </ol>

7	Punime në sistemin e ecjes dhe të varjes së automjetit të lehtë	MK-18-257-21	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti kryen shërbime në sistemin e ecjes së automjetit.</li> <li>2. Kursanti kryen shërbime në sistemin e varjes së automjetit.</li> </ol>
---	---	--------------	--	---

## VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

## VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Automekanikë:

### 1. Moduli “Hyrje në profesionin e automekanikut”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	<b>HYRJE NE PROFESIONIN E AUTOMEKANIKUT</b>	<b>MK-18-251-21</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të automekanikut për automjetet e lehta, me ndërtimin dhe funksionimin e automjeteve të lehta, me dokumentacionin teknik përkatës, me procedurat e mirëmbajtjes, riparimit dhe shërbimit të automjetit, me rregullat për mbrojtjen në punë dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë shërbimit të automjeteve të lehta.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	60 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të automekanikut.</b>  <b>Kriteret e vlerësimit:</b>                      Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së automekanikut në automjetet e lehta.</li> <li>- të përshkruajë kërkesat profesionale për riparuesit dhe mirëmbajtësit e automjeteve.</li> <li>- të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të automekanikut.</li> <li>- të përshkruajnë ndërtimin, funksionimin dhe pajisjen e një servisi për shërbimet në automjetet e lehta.</li> <li>- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdoren për shërbimet në automjetet e lehta.</li> <li>- të tregojë organizimin në një servisi për shërbimet në automjetet e lehta.</li> <li>- të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.</li> <li>- të përshkruajë kuadrin ligjor bazë që vepron në sektorin e shërbimeve në automjetet e lehta.</li> <li>- të shpjegojë zbatimin e kodit të punës dhe kërkesat ligjore për hapjen dhe veprimtarinë e bizneseve për shërbimet në automjetet e lehta.</li> <li>- të përshkruajë zërat që konsiderohen për llogaritjen kostos dhe çmimit të shërbimeve në automjetet e lehta.</li> <li>- të kryejë llogaritje ekonomike të thjeshta për shërbimet në automjetet e lehta.</li> </ul>	

- 
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimin e kryer.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

**RM 2 Kursanti përshkruan ndërtimin e përgjithshëm të automjeteve të lehta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë klasifikimin e mjeteve të transportit.
- të listojë sistemet kryesore të automjeteve të lehta.
- të përshkruajë kornizën (shasinë), karrocërinë dhe llojet e tyre.
- të përshkruajë rolin dhe llojet e motorëve me djegie të brendëshme (MDB).
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të transmetimit të fuqisë.
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të drejtimit.
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të frenimit.
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ecjes.
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të varjes.
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit elektrik.
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit elektronik/kompjuterik të automobilin.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

**RM 3 Kursanti përshkruan motorët për automjetet e lehta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë llojet dhe veçoritë e MDB,
- të përshkruajë skemën e ndërtimit të MDB,
- të përshkruajë funksionimin e motorëve me përzierje të brendshme,
- të përshkruajë parimin dhe ciklin e punës së MDB me katër kohë, me benzinë,
- të përshkruajë parimin dhe ciklin e punës së MDB me katër kohë, me naftë,
- të përshkruajë parimin dhe ciklin e punës së MDB me dy kohë.
- të shpjegojë ndërtimin e përgjithshëm të MDB të tipeve “Otto” dhe “Diezel”,
- të shpjegojë parametrat dhe regjimet kryesore të punës së MDB,

- të listojë pjesët kryesore të palëvizshme dhe të lëvizshme të motorit
- të përshkruajë bllokun e cilindrave dhe cilindrat,
- të përshkruajë kokën e motorit,
- të përshkruajë karterin dhe nënkarterin,
- të listojë mekanizmat dhe sistemet kryesore të MDB,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmit bjellë-manivelë,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmit gaz-shpërndarës,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ndezjes së MDB,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të lëshimit të MDB,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ushqimit të MDB,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të shkarkimit të gazeve të MDB,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ftohjes së MDB,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të vajisjes së MDB,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit elektrik të MDB,

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RM 4 Kursanti përshkruan pjesët xhenerike të automjeteve të lehta**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të tregojë rolin, llojet, ndërtimin dhe funksionimin e friksionit në automjetet e lehta,
- të interpretojë skemën e ndërtimit dhe funksionimit të friksionit,
- të përshkruajë rolin, llojet dhe ndërtimin e mekanizmave të komandimit të friksioneve
- të tregojë rolin e kutisë së shpejtësisë në automjetet e lehta
- të listojë llojet e kutive të shpejtësisë dhe tregojë veçoritë e tyre,
- të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e kutive të shpejtësisë manuale.
- të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e kutive të shpejtësisë automatike dhe robotike.
- të përshkruajë llojet dhe ndërtimin e mekanizmave të komandimit të kutive të shpejtësisë,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e transmisionit kardanic,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e transmisionit kryesor,



- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e diferencialit,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e gjysmëboshteve,
- të përshkruajë rolin, llojet, ndërtimin dhe funksionimin e varëseve,
- të përshkruajë elementet mbështetës, rrotat,
- të përshkruajë skemën e ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të drejtimit,
- të përshkruajë skemën e ndërtimit dhe funksionimit të llojeve të përforcuesve të sistemit të drejtimit,
- të përshkruajë skemën e ndërtimit dhe funksionimit të llojeve të sistemeve të frenimit,
- të përshkruajë skemën e ndërtimit dhe funksionimit të llojeve të frenave stacionare (dorës),

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RM 5 Kursanti përshkruan sistemin elektrik të automjeteve të lehta**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të tregojë rolin dhe pjesët kryesore të sistemit elektrik të automjetit të lehtë.
- të interpretojë skemën, funksionimin dhe elementet përbërëse të sistemit të furnizimit me energji elektrike të automjetit të lehtë.
- të përshkruajë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e baterisë.
- të përshkruajë qëllimin, ndërtimin dhe funksionimin e alternatorit.
- të përshkruajë qëllimin, funksionimin dhe elementët përbërëse të sistemit të ndriçim-sinjalizimit të automjetit të lehtë
- të përshkruajë qëllimin, skemën, funksionimin dhe elementët përbërës të pajisjeve elektrike ndihmëse të automjetit të lehtë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RM 6 Kursanti përdor dokumentacionin teknik për punimet në MDB.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë qëllimin dhe rëndësinë e dokumentacionit teknik,
- të interpretojë simbolet dhe skemat e ndryshme të automjeteve të lehta,
- të realizojë zbërthimin nga skema të elementëve të

- sistemeve të ndryshme në automjetet e lehta,
- të interpretojë skemat kinematike që paraqesin ndërtimin dhe funksionimin e automjeteve të lehta,
- të interpretojë skemat hidraulike të automjeteve të lehta,
- interpretojë skemat elektrike të thjeshta,
- të interpretojë llojet e ndryshme të bashkimeve të pjesëve të ndryshme,
- të përshkruajë materialet kryesore të pjesëve të ndryshme, si dhe vetitë e tyre fizike, kimike dhe mekanike,
- të përshkruajë matjet teknike të thjeshta në automjete dhe instrumentat matëse përkatëse,
- të shpjegojë çfarë janë saktësia përmasave dhe cilësia e sipërfaqeve të detaleve,
- të shpjegojë çfarë janë tolerancat e përmasave dhe gjeometrike të detaleve dhe si ndikojnë ato në çiftet e detaleve,
- të konsultohet me instruksionet e prodhuesit për zbatimin e standarteve të çmontim/montimit të pjesëve të ndryshme,
- të interpretojë momentet përdredhës në shtrëngim, këndet e shtrëngimit të përcaktuara,
- të konsultohet me instruksionet e prodhuesit për zbatimin e standarteve të çmontim/montimit për shërbimet dhe riparimet e automjetit.
- të konsultohen me instruksionet e prodhuesit për fluidët/lubrikuesit që përdoren në automjetet e lehta,
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët që zëvendësohen.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RM 7 Kursanti përshkruan mirëmbajtjen, riparimin dhe diagnostikimin në automjetet e lehta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të detaleve dhe të pjesëve të përbërëse të sistemeve të automjeteve të lehta.
- të shpjegojë si ndodh konsumimi i detaleve dhe nyjeve të sistemeve të automjeteve të lehta dhe roli i faktorëve të ndryshëm në konsumim.
- të tregojë masat për parandalimin dhe pakësimin e dëmtimeve të sistemeve të automjeteve të lehta.
- të përshkruajë metodat e riparimit të sipërfaqeve, të detaleve dhe nyjeve të mekanizmave dhe sistemeve të ndryshme.
- të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në sistemet dhe mekanizmat e automjeteve të lehta.
- të klasifikojë llojet e shërbimeve në sistemet e ndryshme të automjeteve të lehta.
- të tregojë veçoritë e shërbimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta.

- të tregojë veçoritë e shërbimeve teknike periodike në automjetet e lehta.
- të tregojë veçoritë e shërbimeve të riparimit në automjetet e lehta.
- të tregojë veçoritë e riparimeve të çastit në automjetet e lehta.
- të përshkruajë rëndësinë e diagnostikimi të parregullsive në automjetet e lehta.
- të përshkruajë metodat kryesore dhe pajisjet për diagnostikimin e parregullsive në automjetet e lehta.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RM 8 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e automjeteve të lehta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të ruajtjes së personit në punë gjatë punimeve në shërbimet e automjeteve të lehta,
- të shpjegojë masat e mbrojtjes në mjediset e punës për shërbimet e automjeteve të lehta,
- të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë kryerjes së shërbimeve të mjeteve të transportit duke shpjeguar mënyrën e shmangies së tyre,
- të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm,
- të shpjegojë rëndësinë dhe përbërjen e kutisë së ndihmës së parë,
- të përdorë drejt mjetet dhe medikamentet e ndihmës së parë,
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e plagosjeve,
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e humbjes së vetëdijes,
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit,
- të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e automjeteve të lehta,
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga rryma elektrike,
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zjarri,
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me ngarkesa dhe pesha të rënda,
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme,
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit dhe gjatë kryerjes së punimeve me lëngje dhe gaze të ndryshme,
- të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së reparit të shërbimeve në automjetet e lehta. Rekomandohen dhe vizita e praktikim në servise të automjeteve të lehta.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në reparit të servisit të automjeteve të lehta. Atyre duhet t'i jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Reparte të shërbimit të automjeteve të lehta.
  - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
  - Medie didaktike (CD, filma, etj) për konkretizimin e njohurive dhe aftësive.
-

## 2. Moduli “Punime në motorin e automjetit të lehtë”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PUNIME NË MOTORIN E AUTOMJETIT TË LEHTË</b>	<b>MK-18-252-21</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson kursantët për të kryer punime të ndryshme të zmontimit dhe montimit të motorëve me djegie të brendshme të automjeteve, si dhe punime të mirëmbajtjes dhe të riparimit në sistemet dhe mekanizmat tij.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e automekanikut”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Kursanti zmonton e monton pjesët e motorit të automjetit.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të motorit të automjetit.</li><li>- të përcaktojë drejt rradhën e punës për zmontimin e montimin e pjesëve të motorit.</li><li>- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura për zmontimin e montimin e pjesëve të motorit.</li><li>- të përgatitë motorin dhe vendin e punës për zmontim e montim të motorit.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të elementeve të sistemit të ushqimit.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të elementeve të sistemit të ftohjes.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të elementeve të sistemit të ndezjes.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të elementeve të sistemit të lëshimit.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të kokës së motorit.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të nënkarterit.</li><li>- të zbatojë procedurat e zmontimit e montimit të elementeve të sistemit të vajisjes.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të boshtit me gunga dhe elementeve të shpërndarjes së gazeve.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit e montimit të boshtit të motorit.</li><li>- të zbatojë procedurat e duhura të zmontimit të grupit piston-cilindër.</li></ul>	

- të pastrojë dhe sistemojë si duhet pjesët e zmontuara të motorit.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet dhe punën e kryer.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zmontimit dhe montimit të pjesëve kryesore të motorit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 2 Kursanti kryen shërbime në mekanizmat e motorit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit.
- të përgatitë vendin e punës për punime në mekanizmat e motorit.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në mekanizmat e motorit.
- të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë në mekanizmat e motorit.
- të realizojë matje dhe kontrole paraprake për përcaktimin e saktë të parregullsive të motorit.
- të çmontojë lidhjet e motorit me agregatet tjera.
- të çmontojë motorin nga automjeti (nëse është e nevojshme), ta pastrojë e lajë dhe ta vendosë në bangon e punës
- të shkëputë lidhjet e kokës së motorit me elementet e tjera
- të zbatojë procedurën e çmontimit të kokës së motorit.
- të matë, kontrollojë dhe përcaktojë parregullsitë e ndryshme të kokës së motorit
- të zbatojë procedurën e pastrimit të dhomave të djegies në kokën e motorit.
- të zbatojë procedurën e pastrimit dhe e rrafshimit të sipërfaqes së kokës së motorit.
- të zbatojë procedurën e çmontimit të guarnicionit të kokës së motorit dhe pastrojë sipërfaqen e bllokut të cilindrave.
- të zbrazë vajin nga nënkarteri i motorit.
- të zbatojë procedurën e çmontimit të nënkarterit dhe guarnicionit të tij.

***Te mekanzmi biellë- manivelë:***

- të zbatojë procedurën e çmontimit nga boshti motorik dhe kontrollit të nyjeve piston-biellë.
- të zbatojë procedurën e çmontimit dhe kontrollit të elementeve të nyjes piston-biellë (biellës, bokullës së biellës, bronxinave, spinotit, pistonit, fashove).
- të zbatojë procedurën e çmontimit dhe kontrollit të boshtit motorik.

- të zbatojë procedurën e çmontimit të permistopave, të rrotës me dhëmbë të shpërndarjes dhe volantit nga boshti motorik.
- të realizojë kontrollet dhe matjet e qafave të boshtit motorik, si dhe të përzgjedhë përmasat riparuese të tyre.
- të zbatojë procedurën e kontrollit të bangove dhe kushinetave (bronxinave) të boshtit motorik.
- të realizojë kontrollet dhe matjet e këmishave të cilindrave, si dhe të përzgjedhë përmasat riparuese të tyre.
- të zbatojë procedurën e çmontimit dhe e montimit të këmishave të reja (nëse duhet të zëvendësohen).
- të zbatojë procedurën e pastrimit të vrimave dhe kanaleve të kalimit të vajit në elementet e mekanizmit bjellë manivelë;
- të zbatojë procedurën e pastrimit të kanaleve dhe dhomave të kalimit të lëngut ftohës në bllokun e cilindrave;
- të zbatojë procedurën e montimit të elementeve të nyjes piston-biellë (biellës, bokullës së biellës, bronxinave, spinotit, pistonit, fashove).
- të zbatojë procedurën e montimit dhe e përshtatjes së boshtit motorik, kushinetave dhe bangove të tij.
- të zbatojë procedurën e montimit të nyjeve piston-biellë me qafat e boshtit motorik.
- të zbatojë procedurën e montimit në boshtin motorik, të rrotës me dhëmbë të shpërndarjes dhe volantit.
- të zbatojë procedurën e montimit të guarnicionit dhe kokës së motorit.
- të realizojë montimin e lidhjeve dhe pjesëve të çmontuara nga koka dhe trupi i motorit.
- të zbatojë procedurën e montimit të guarnicionit dhe nënkarterit të motorit.
- të hedhë vajin në nënkarterin e motorit.
- të montojë motorin në automjet (nëse është është hequr më parë).
- të realizojë provën e funksionimit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuara të mekanizmit bjellë manivelë.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogëve) për të përzgjedhur pjesët e mekanizmit bjellë manivelë që do të zëvendësohen.

***Te mekanizmi i shpërndarjes së gazeve të motorit:***

- të marrë informacion paraprak për parregullsitë në mekanizmin shpërndarjes së gazeve të motorit.
- të heqë kapakun e valvolave dhe kapakun e rrotave të dhëmbëzuara ose zinxhirit të shpërndarjes.
- të realizojë kontrollin pamor-dëgjimor të funksionimit të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve dhe përcaktimine parregullsive.
- të realizojë kontrollin dhe matjen e hapësirave termike midis bishtave të valvolave dhe elementeve që transmetojnë lëvizjen, si dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të zbatojë procedurën e çmontimit të nyjeve të valvolave.

- të zbatojë procedurën e çmontimit të elementeve që transmetojnë lëvizjen nga boshti me gunga te bishtat e valvolave.
- të zbatojë procedurën e heqjes së zinxhirit të shpërndarjes (kur ka të tillë).
- të zbatojë procedurën e çmontimit të rrotës me dhëmbë (ose rrotës yll) të boshtit me gunga.
- të zbatojë procedurën e çmontimit të boshtit me gunga dhe elementeve të tij.
- të zbatojë procedurën e çmontimit të foleve (sedieve) dhe udhëzuesve (guidave) të valvolave (nëse është e nevojshme).
- të realizojë matjet dhe kontrollet e pjesëve të çmontuara, si dhe përcaktimin e parregullsive.
- të përzgjedhë pjesët e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve që do të zëvendësohen.
- të zbatojë procedurën e montimit të foleve dhe udhëzuesve të valvolave.
- të zbatojë procedurën e frezimit dhe zmerilimit të foleve të valvolave (kur është e nevojshme).
- të zbatojë procedurën e montimit të boshtit me gunga dhe elementeve të tij.
- të zbatojë procedurën e montimit në bosht e rrotës me dhëmbë (ose rrotës yll) sipas shenjave të vënies në fazë.
- të zbatojë procedurën e montimit të elementeve që transmetojnë lëvizjen nga boshti me gunga te bishtat e valvolave.
- të zbatojë procedurën e montimit të nyjeve të valvolave.
- të zbatojë procedurën e vendosjes së zinxhirit të shpërndarjes (kur ka të tillë) dhe vendosjes në fazë të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve.
- të zbatojë procedurën e regjistrimit të hapësirave termike midis bishtave të valvolave dhe elementeve që transmetojnë lëvizjen (kur nuk janë vetëregjistruese).
- të realizojë kontrollin e funksionimit të mekanizmit të riparuar të shpërndarjes së gazeve dhe mënjanimin e parregullsive të mundshme.
- të realizojë montimin e kapakut të valvolave dhe kapakut të rrotave të dhëmbëzuara ose zinxhirit të shpërndarjes, si dhe gurnicioneve të tyre.
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogëve) për të përzgjedhur pjesët e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve që do të zëvendësohen.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet.
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit të mekanizmave të motorit.



***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

**RM 3 Kursanti kryen shërbime në sistemin e ushqimit të motorit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë dokumentacionin teknik të motorit.
- të përgatitë vendin e punës për punime në sistemin e ushqimit të motorit.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për punime në sistemin e ushqimit të motorit.
- të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës.
- të marrë informacion paraprak për parregullsitë në sistemin e ushqimit të motorit.
- të realizojë kontrollin e elementeve të sistemit të ushqimit e shkarkimit të motorit dhe përcaktimin e parregullsive.
- të zbatojë procedurat e zëvendësimit të filtrave të sistemit të ushqimit të motorit.
- të realizojë përzgjedhjen e filtrave të duhur të sistemit të ushqimit;
- të realizojë shkëputjen nga filtri të tubave të prurjes dhe dërgimit të lëndës djegëse;
- të realizojë bllokimin e tubit të prurjes për mosrjedhjen e lëndës djegëse;
- të realizojë çmontimin dhe heqjen e filtrit të lëndës djegëse;
- të realizojë montimin e filtrit të ri të lëndës djegëse;
- të realizojë bashkimin e filtrit të lëndës djegëse me tubat e prurjes dhe të dërgimit të lëndës djegëse.
- të realizojë provën e funksionimit të filtrave të sistemit të ushqimit të motorit.

***Te sistemi i ushqimit me naftë (diesel)***

- të zbatojë procedurën e zëvendësimit të injektorëve të naftës të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”.
- të bëjë përzgjedhjen e injektorëve të duhur të sistemit të ushqimit të motorit.
- të realizojë shkëputjen nga injektorët të tubave të dërgimit dhe të rikthimit të naftës;
- të realizojë çmontimin dhe heqjen e injektorëve nga koka e motorit;
- të realizojë vendosjen dhe montimin e injektorëve të rinj;
- të realizojë lidhjen me injektorët të tubave të dërgimit dhe të rikthimit të naftës,
- të realizojë provën e funksionimit të injektorëve të zëvendësuar.
- të zbatojë procedurat e zëvendësimit të pompës së presionit të ulët të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”;
- të realizojë shkëputjen nga pompa e presionit të ulët të

- tubit të dërgimit dhe tubit të prurjes së naftës;
- të realizojë bllokimin e tubit të prurjes për mos rrjedhjen e naftës;
- të realizojë çmontimin dhe heqjen e pompës së presionit të ulët;
- të realizojë kontrollin dhe riparimin e pompës së presionit të ulët (nëse është e nevojshme).
- të realizojë përzgjedhjen e pompës së re të presionit të ulët (nëse është e nevojshme);
- të realizojë vendosjen dhe montimin e pompës së riparuar (ose të re) të presionit të ulët;
- të realizojë lidhjen e pompës së presionit të ulët me tubin e dërgimit dhe tubin e prurjes së naftës;
- të realizojë provën e funksionimit të pompës së presionit të ulët të zëvendësuar.
- të zbatojë procedurat e zëvendësimit të pompës së naftës (të presionit të lartë) të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”;
- të realizojë përzgjedhjen e pompës së duhur të naftës;
- të realizojë shkëputjen nga pompa e naftës e lidhjeve elektrike;
- të realizojë shkëputjen nga pompa e naftës dhe nga injektorët e tubave të prurjes dhe të dërgimit të naftës;
- të realizojë çmontimin dhe heqjen e pompës së naftës;
- të organizojë kontrollin, riparimin dhe regjistrimin e pompës së naftës në një servis të specializuar.
- të realizojë vendosjen në fazë dhe montimin e pompës së naftës, të re ose të riparuar;
- të realizojë lidhjen me pompën e naftës të tubave të prurjes dhe tubave të dërgimit të naftës në injektorë;
- të realizojë vendosja e lidhjeve elektrike në pompën e naftës;
- të realizojë provën e funksionimit të pompës së naftës, të re ose të riparuar.

***Te sistemi i ushqimit me benzinë***

- të zbatojë procedurat e zëvendësimit të pompës së benzinës së sistemit të ushqimit të motorit me injeksion benzine:
- të realizojë shkëputjen nga pompa e benzinës e tubit të dërgimit dhe tubit të prurjes së benzinës;
- të realizojë bllokimin e tubit të prurjes për mosrrjedhjen e benzinës;
- të realizojë shkëputjen e lidhjeve elektrike të pompës së benzinës;
- të realizojë çmontimin dhe heqjen e pompës së benzinës;
- të realizojë kontrollin dhe riparimin e pompës së benzinës (nëse është e nevojshme).
- të bëjë përzgjedhjen e pompës së re të benzinës (nëse është e nevojshme);
- të realizojë vendosjen dhe montimin e pompës së riparuar (ose të re) të benzinës;

- të realizojë lidhjen e pompës së benzinës me tubin e dërgimit dhe tubin e prurjes së benzinës;
- të kryejë lidhjet elektrike të pompës së benzinës;
- të realizojë provën e funksionimit të pompës së benzinës të zëvendësuar, të motorit me injeksion benzine.
- të zbatojë procedurat e riparimi ose zëvendësimit të injektorëve të sistemit të ushqimit të motorit me injeksion benzine:
- të realizojë përzgjedhjen e injektorëve të duhur të sistemit të ushqimit me injeksion benzine;
- të realizojë shkëputjen nga injektorët e tubave të dërgimit dhe të rikthimit të benzinës;
